



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0454

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Panelist Individual, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “ARITECH”, kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “KOMUNA E VUSHTRRISË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje të teknologjisë informative” me numër të prokurimit VU644-25-1910-5-5-8, me 29/07/2025, mori:

Vendim

- 1. Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE “ARITECH” me nr. 2025/0454, e datës 05/06/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje të teknologjisë informative” me numër të prokurimit VU644-25-1910-5-5-8.
- 2. Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të “KOMUNA E VUSHTRRISË”, ndërsaq aktiviteti i prokurimit “Furnizim me pajisje të teknologjisë informative” me numër të prokurimit VU644-25-1910-5-5-8 kthehet në **Rivlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “ARITECH”
5. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

“KOMUNA E VUSHTRISË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftim për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me pajisje të teknologjisë informative” me nr. të prokurimit: VU644-25-1910-5-5-8. Ndërsa me datën 22.05.2025 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës. OE “Clastertech”sh.p.k.- Prishtinë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 124,920.00 €.

Me 26.05.2025, OE “ARITECH” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me datën 30.05.2025 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për Rishqyrtim.

Me 05/06/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “ARITECH” me nr. 2025/0454 për lidhur me aktivitetin “Furnizim me pajisje të teknologjisë informative” me nr. të prokurimit: VU644-25-1910-5-5-8.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ARITECH” janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues, me datë 22.05.2025, ka marrë vendim për të eliminuar ofertën e “Aritech SHPK” me arsyetimin e mëposhtëm:

Citojmë:

Përfundim – Citati

Autoriteti Kontraktues, lidhur me kërkesën për sqarime shtesë të datës 13.05.2025, ka kërkuar autorizimin e prodhuesit për pozicionin nr. 9 – HP Z8 G5 Workstation.

Citojmë nga kërkesa e Autoritetit Kontraktues:

Përfundim – Citati

Më datë 14.05.2025, përmes sistemit të e-prokurimit nga ana jone është ngarkuar autorizimi përkatës për produktin HP Z8 G5, si dhe autorizimet e tjera të nevojshme. Edhe pse të njëjtat kanë qene të ngarkuara në AQP!!!

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues më datë 15.05.2025 ka kërkuar sqarime shtesë lidhur me pozicionin nr. 9 – Brand Name Workstation, modeli HP Z8 G5 Workstation, çuditërisht duke shprehur dyshime për çmim jo normalisht të ulët, si dhe për autorizimin e këtij produkti (edhe pse është ngarkuar një ditë përpara, plus asaj që ka qene në AQP).

Citojmë:

Përfundim – Citati

Insistimi mbi kërkesën për autorizim (MAF) është i habitshëm, duke theksuar se ky artikull nuk ndodhet në listën e autorizimeve të kërkuara. Fakti që “Aritech SHPK” është i kualifikuar në AQP nënkupton që ka autorizim për secilin pozicion, përfshirë edhe Workstation-in!

Prandaj, duket qartë që ne fillim, se nuk kemi të bëjmë me një vlerësim profesional, por me një qasje tendencioze!

Sidoqoftë, në sistemin e e-prokurimit kemi ngarkuar përsëri Autorizimin nga prodhuesi për këtë produkt, duke e theksuar me ngjyrë tekstin për HP Workstations.

Ndërsa lidhur me pretendimin e çuditshëm për çmimin jo normalisht të ulët për HP Workstations, theksojmë si më poshtë:

E para nuk janë plotësuar kushtet për tu trajtuar si çmim jo normalisht i ulët, megjithatë “Aritech SHPK”, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, ka siguruar dëshmi të mjaftueshme që çmimi i ofruar për produktin Workstation është çmim tregu dhe nuk përbën çmim jo normalisht të ulët.

Dëshmia konsiston në:

- Çmimi i ofruar nga Operatori Ekonomik në tender në vlerë 5,919.00 EUR është 9.56% më i lartë se kostoja totale e blerjes, transportit, shpenzimeve të doganimit dhe taksave. Kjo është dëshmuar me faturën blerëse për një projekt të vitit aktual të kompanisë “Aritech SHPK” në administratën e shtetit, si dhe me OPG-në nga prodhuesi (OPG është çmimi zyrtar i aprovuar nga prodhuesi HP).
- Marzhi prej 9.56% në projektin në vlerë mbi 100,000 EUR mbulon afërsisht gjysmën e shpenzimeve operative mujore të gjithë kompanisë, që dëshmon se ky produkt, si dhe i gjithë tenderi, është me fitim për kompaninë!
- “Aritech SHPK” është i vetmi partner direkt i HP-së për Kosovën. Duke qenë partner direkt, “Aritech” ka çmime më të favorshme blerëse sesa operatorët e tjerë në treg.

Për më tepër, për të treguar seriozitetin e kompanisë “Aritech SHPK” ne raport me komunën e Vushtrisë, AK është ne dijeni se OE Aritech ka realizuar me sukses projekte të ngjashme gjatë tri viteve të fundit pranë të njëjtit Autoritet Kontraktues, në vlerë totale 419,298 EUR- ne vijim referencat e këtyre projekteve:

- Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative – Ri-tenderim / VU644-22-8499-5-5-8
- Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative / VU644-23-4202-5-5-8
- Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative / VU644-24-7363-5-5-8).

Për këto projekte kemi marrë referenca pozitive nga Autoriteti Kontraktues hiq me larg se këtë muaj!!!!,

Dëmtimi i buxhetit të komunës prej 8,697.78 EUR për shkak të një hamendësimi të pabazuar nga Autoriteti Kontraktues është i dëmshëm për komunën, ndërkohë që ne si operator jemi të detyruar të

kërkojmë të drejtën tek Ju, gjë që për AK mund të këtë vonesa shtese te panevojshme dhe harxhim te resurseve te OSHP.

Për të vërtetuar më tej këtë dhe si dëshmi shtesë, kemi siguruar Dokumentin Unik Doganor (DUD) që lëshohet nga Drejtoria e Doganave te Kosovës, me të cilin është bërë zhdoganimi për sasinë prej 4 copësh Workstation IDENTIK. Ky dokument është bashkëngjitur së bashku me faturën blerëse dhe faturën shitëse për Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Dokumenti Unik Doganor – Nr. R2211

Artikulli 4: HP Workstation Tower Z8 G5

- 2x CPU Xenon 5418Y
- 32GB RAM
- 1 TB SSD
- 2 TB HDD
- 8GB Kartelë Grafike

Çmimi njësi (pa taksa): 4,858.10 EUR

Totali për 4 cope: 19,432.40 EUR

Vlerësim për çmimin e ofruar nga “Aritech SHPK”:

Vlerësojmë se kemi ofruar dëshmi mëse të mjaftueshme për të lehtësuar vendimmarrjen e Autoritetit Kontraktues.

Për më tepër, çmimi i ofruar nga “Aritech SHPK” nuk përmbush kriteret për të kërkuar sqarime shtesë në lidhje me çmimin jo normalisht të ulët.

Sipas Rregullores përkatëse me Nr. 002/2024, për të klasifikuar një ofertë si “jo-normalisht të ulët” apo për të kërkuar sqarime mbi çmimin e ofruar, duhet të plotësohen kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

Citojmë nga Neni 41 – Tenderët Jo-normalisht të Ulët:

Përfundim – Citati:

Megjithatë, është për t’u habitur se sa shumë energji dhe kohë ka humbur Autoriteti Kontraktues duke analizuar vetëm një pozicion të vetëm, ndërsa nuk ka shqyrtuar fare me kujdes të gjithë tabelën e çmimeve të ofruara nga Operatori Ekonomik “Clastertech SHPK”, i cili është propozuar për shpërblim me kontratë.

Më poshtë gjendet tabela e çmimeve të ofruara nga “Clastertech SHPK”:

Gabimet në llogaritjen e TVSH-së dhe çmimeve për njësi:

Nga shqyrtimi i tabelës së ofertave të dorëzuara nga Operatorët Ekonomikë, rezulton se të gjitha pozicionet e çmimeve janë kalkuluar gabim nga OE që është propozuar për t'u shpërblyer me kontratë.

Ky operator nuk ka aplikuar normat ligjore të TVSH-së prej 8% dhe 18%, sipas natyrës së produkteve, dhe si rrjedhojë kemi të bëjmë me gabime aritmetike që tejkalojnë 2%, çka sipas legjislacionit për prokurimin publik e klasifikon ofertën si të papërgjegjshme.

Shembull konkret

- Pozicioni nr. 1

- o Çmimi njësi pa TVSH: 111.84 euro

- o Çmimi njësi me TVSH të deklaruar: 112.04 euro

- o Gabimi i dukshëm: TVSH prej vetëm 0.18 euro është në kundërshtim me normën ligjore.

- o Llogaritja korrekte, nëse çmimi bazë real do të ishte 111.84 euro dhe aplikohet 18% TVSH, do të rezultonte:

- ? $111.84 + (111.84 \times 0.18) = 131.97$ euro

Ky është vetëm një nga pozicionet ku llogaritjet janë bërë gabim. Gabime të ngjashme shfaqen në të gjitha pozicionet e tjera në tabelën e ofertës, për shkak të moszbatimit të normës së duhur të TVSH-së dhe gabimeve në shumzimet aritmetike.

Me ngjyrë të kuqe janë shënuar çmimet e korrigjuara.

Sipas përlllogaritjes së re, pas përmirësimit të çmimeve, totali i ofertës rezulton të jetë 122,945.96 EUR. Gabimi aritmetik në total është 8%, çka e klasifikon ofertën si të papërgjegjshme, sipas kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe LPP, dhe njëkohësisht e rendit këtë ofertë si më të shtrenjtën ndër operatorët konkurrues.

Nga ana tjetër, besojmë se janë siguruar dëshmi të mjaftueshme, ligjërisht të vlefshme dhe të verifikueshme, që "Aritech SHPK" ka ofruar çmim me fitim të theksuar dhe të argumentuar, veçanërisht për pozicionin për të cilin AK ka pasur dyshime. Kjo përjashton plotësisht mundësinë që të kemi të bëjmë me një çmim jo normalisht të ulët, dhe si e tillë, oferta e "Aritech SHPK" duhet të trajtohet si e përgjegjshme.

Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues ka ardhur me një përgjigje e cila, përveç pretendimeve fillestare mbi autorizimin për Workstation dhe dyshimeve të pabazuara mbi çmimin jo normalisht të ulët, ka përfshirë edhe pretendime të tjera shtesë, po aq të pabazuara.

Në mënyrë të pabesueshme, AK ka kualifikuar "Aritech SHPK", përkatësisht parashtresin e ankesës, si person jo kompetent për të paraqitur kërkesën për rishqyrtim – pavarësisht se kërkesa është nënshkruar nga pronari i kompanisë, z. Fahri Avdiu, dhe është dorëzuar me vulën zyrtare të kompanisë.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues ka kaluar përtej kompetencave të tij, duke ndërmarrë "zbulime" të panevojshme, pa marrë parasysh se "Aritech SHPK" ka realizuar më parë disa kontrata me Komunën e

Vushtrisë dhe ka ndjekur të njëjtën praktikë të dorëzimit të ofertave, gjithnjë në përputhje me kërkesat ligjore.

Për të gjitha ofertat, përfshirë edhe këtë të fundit, dokumentet janë dorëzuar në emër të pronarit Fahri Avdiu, të nënshkuara prej tij dhe të vulosura nga kompania, në përputhje të plotë me Ligjin për Prokurimin Publik.

Në vijim deklarata nën betim për lenden e njëjtë:

Ne shprehim habinë tonë se si Autoriteti Kontraktues vazhdon të paraqesë pretendime të pabazuara dhe të paarsyeshme. Fillimisht, nuk arrin të shohë autorizimin për HPWorkstations, dhe më pas injoron faktin se e gjithë oferta e dorëzuar dhe nënshkruar nga pronari i kompanisë, z. Fahri Avdiu.

Gjithashtu, edhe në lidhje me kërkesën për rishqyrtim, AK vazhdon me pretendime të pabazuara, duke shpërfillur të dhënat faktike.

Për më tepër, kërkesa për rishqyrtim është nënshkruar drejtpërdrejt nga pronari i kompanisë, z. Fahri Avdiu, çka e bën të panevojshme çdo koment mbi përfaqësimin apo autorizimin, duke e dëshmuar edhe një herë se pretendimet e AK-së nuk kanë mbështetje ligjore apo faktike..

Autoriteti Kontraktues ka dëshmuar qartë se nuk ka kryer një vlerësim të drejtë dhe objektiv, pasi vazhdon të insistojë në pretendime të pabazuara dhe nuk merr fare në konsideratë argumentet e paraqitura nga “Aritech SHPK”, përfshirë edhe pretendimin për çmim jo normalisht të ulët.

Madje, pa u mjaftuar me këto, AK ka shpikur pretendime të tjera të pabazuara, duke u larguar plotësisht nga parimet themelore të vlerësimit të drejtë dhe të paanshëm.

Për më tepër, në lidhje me pretendimin e Autoritetit Kontraktues se kërkesa për rishqyrtim ishte paraqitur nga një person jo kompetent, theksojmë se në zyrat e AK-së ekziston dokumenti përkatës – autorizimi për z. Faton Ibrahim. Edhe pse në këtë rast nuk ishte i nevojshëm fare autorizimi, i cili gjendet tek Autoriteti Kontraktues i kërkuar për qasje në dokumente. Sikur mos ta kishim pasur këtë dokument, AK kaq i interesuar ta rrezojë ofertën tone, nuk do të na kishte dhënë qasje fare në dokumentacion!

Për këto arsye, vlerësojmë se AK ka vepruar në kundërshtim të plotë me kriterin “Vlera për parane”, pasi nëse do ta kishte zbatuar këtë parim, do të kishte shqyrtuar të gjitha dokumentet ekzistuese dhe do të kishte vlerësuar ofertat në mënyrë të drejtë dhe të balancuar.

Më tej, vlerësimi i Autoritetit Kontraktues rezulton të jetë tendencioz, i pa balancuar dhe i drejtuar ekskluzivisht kundër Operatorit Ekonomik “Aritech SHPK”, duke anashkaluar plotësisht gabimet aritmetike dhe llogaritjet e pasakta të TVSH-së në ofertën e Operatorit Ekonomik “Clastertech SHPK”.

Të gjitha këto gabime në përshkrimin e çmimeve nga “Clastertech SHPK” janë dokumentuar dhe paraqitur më lart, me fakte të qarta dhe të pakundërshtueshme. AK lidhur me këtë ka theksuar si në vijim;

Citojmë;

Përfundim – Citati :

Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se ka bërë korrigjimin e TVSH-së.

Megjithatë, ne nuk kemi parë asnjë dokument mbështetës (siç është formulari B49) nga ana e AK-së që vërteton këtë korigjim që është kërkesë ligjore!

Në realitet, Autoriteti Kontraktues nuk ka ndryshuar asnjë çmim. Po të ishte bërë vërtet korigjim i çmimit, nuk do të ishte e mundur që totali i përgjithshëm të mbetej i njëjtë me përshkrimin e çmimit.

Nga vendimi I AK-se:

Citojmë:

Përfundim – Citati:

Si është e mundur që pas "korigjimit" të çmimit të mos ndryshojë as edhe një cent?!

Kjo dëshmon qartë se Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë asnjë korigjim, as të TVSH-së dhe as të çmimeve njësi me TVSH (pasi çmimet pa TVSH nuk preken!)

Siç dihet, sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), çmimi bazë është çmimi njësi pa TVSH, dhe çdo korigjim duhet të bëhet mbi këtë bazë. Praktika të tilla janë të zakonshme në aktivitetet e prokurimit në të gjitha Autoritetet Kontraktuese (AK).

Në të kundërt, nëse një AK vendos të bëjë korigjime bazuar herë në çmimin me TVSH dhe herë në çmimin pa TVSH, sipas konvencencës, kjo krijon precedent të rrezikshëm dhe nxit Operatorët Ekonomikë të deklarojnë, për shembull, një normë të TVSH-së prej vetëm 1%. Një korigjim i tillë do të mundësonte keqpërdorime në varësi të pozicionimit në procesverbalët e vlerësimit. Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP):

Të ndërmarrë masa ndaj Autoritetit Kontraktues, në veçanti ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit, për të gjitha shkeljet e paraqitura, të cilat janë drejtuar në mënyrë selektive vetëm ndaj kompanisë “Aritech SHPK”.

Tendenca dhe insistimi për eliminimin e ofertës së “Aritech SHPK” nëpërmjet pretendimeve të paqëndrueshme nuk duhet të tolerohen. Prandaj, vlerësojmë se duhet të ndërmerren masa përkatëse sipas LPP-së, me qëllim që të ndalet kjo qasje e padrejtë, e cila, përveç dëmeve financiare ndaj “Aritech SHPK” dhe vetë AK-së, rrit edhe koston e projektit pa asnjë bazë të justifikueshme.

Përfundim:

Vlerësojmë se “Aritech SHPK” ka dorëzuar një ofertë të përgjegjshme, duke respektuar të gjitha rregullat, si ato tregtare ashtu edhe ato ligjore.

Oferta e “Aritech SHPK” për të gjitha pozicionet, përfshirë edhe pozicionin nr. 9 – “Brand Name Workstation”, përmban çmime me fitim të përcaktuar, për të cilat janë ofruar dëshmi të mjaftueshme.

Gjithashtu, “Aritech SHPK” ka paraqitur dëshmi për furnizime të mëparshme për të njëjtin pozicion dhe me specifikime të njëjta teknike, të gjitha me çmime që përfshijnë fitim të përcaktuar.

Tendenca për të eliminuar ofertën e “Aritech SHPK” ngjall dyshime për mundësi të interesave të tjera, apo favore të caktuara ndaj individëve brenda Autoritetit Kontraktues, duke marrë parasysh insistimin

për të krijuar pretendime të paqëndrueshme.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “ARITECH” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim AK ka shkelur dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si më poshtë: - Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti - Neni 7: Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi - Neni 59: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve - Neni 41 i Rregullores 002/2024: Tenderët Jo-normalisht të Ulët. Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të marrë vendim si më poshtë: V E N D I M Aprovohet si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik “ARITECH SHPK” lidhur me tenderin “Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative”, me numër prokurimi UA/2016-24-3927-1-1-1/C549. Anullohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues nga “Komuna e Vushtrrisë” dhe urdhërohet që tenderi të rikthehet në rivlerësim. Vlerësimi të bëhet në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit, Rregullores për Prokurim Publik dhe Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Vlerësimi i drejtë nënkupton shpalljen fituese të kompanisë “ARITECH SHPK”, si ofertë e përgjegjshme dhe më e lira në këtë projekt tenderues.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues: Autoriteti Kontraktues - Drejtoria Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të rezultatit nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që, në aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative , Nr. i prokurimit: VU644 - 25 - 1910 - 5-5-8 e Nr. i brendshëm: VU644-25-011-558 , ta rekomandoi për dhënie të kontratës : OE.: “ Clastertech “sh.p.k. me seli në Prishtinë me nr. të ARBK : 811159096, ndërsa, O.E.: “ Aritech “sh.p.k., me seli në km. 10 Prishtinë - Lipjan, me nr. të ARBK : 810821828 (në tekstin e mëtejme Ankuesin) ta renditë në mesin e O.E. të eliminuar, bazuar në procedurën e zbatuar.

Njoftimi mbi Vendimin e A.K. si dhe Njoftimi letër për tenderuesin e eliminuar për Ankuesin, bazuar në dispozitat e nenit 42 paragrafi 42.1 të Rregullores nr. 002/2024 - Plotësim ndryshimi i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, janë dërguar për publikim në platformën elektronike më dt. 22.05.2025.

Në Kërkesën për rishqyrtim, e cila është parashtruar në afatin ligjorë, Ankuesi konsideron se, duke vendosur si në Vendimin e dt. 22.05.2025, A.K. ka shkelur dispozitat e LPP-së , konkretisht: nenin 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, nenin 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, nenin 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, nenin 41 të Rregullores nr. 2022/2024 për Prokurimin Publik, Tenderët jo-normalisht të ulët.

Pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtruara në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, Autoriteti Kontraktues gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë , për arsye se:

1.Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, neni 7 ka pasur për qëllim trajtimin e barabartë, pa diskriminuar asnjë prej O.E. pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, Neni 33 paragrafi 1 (Procedurë e Hapur) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 59 (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve) lidhur me nenin 60 paragrafi 1 pika 1.1 (tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët) ka pasur për qëllim, që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të tenderëve, të vendosë për dhënie të kontratës O.E. me tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Mbi këtë bazë A.K. vlerëson se Vendimi i A.K. i dt. 22.05.2025 është marrë bazuar në kushtet , rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të dispozitave të

nenit 59 të LPP-së lidhur me nenin 40 të Rregullores nr. 002/2024 – Plotësim ndryshimi i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, vendimi, sikurse ka vlerësuar A.K., është i mbështetur mbi baza ligjore e faktike, i pandikuar, që nuk diskriminon dhe që ka një transparencë të lartë të vendimmarrjes dhe po ashtu duke zbatuar kërkesat procedurale dhe qenësore të dispozitave të LPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues më tej vlerëson se të gjithë tenderët e tenderuesve në aktivitetin e prokurimit në fjalë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndërsa, i gjithë procesi ka qenë transparent, duke përfshirë këtu edhe të drejtën Ankuesit për të realizuar qasjen në dokumente të tenderit, konform nenit 10 dhe 11 të LPP-së.

3. Autoriteti Kontraktues pasi analizoi përmbajtjen e Kërkesës për Rishqyrtim të Ankuesit, në kuptim të dispozitave të nenit 60 paragrafi 60.3 të Rregullores nr. 002/2024 – Plotësim ndryshimi i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, konstatoi padiskutueshëm mungesën e demonstrimit se parashtruesi i ankesës kualifikohet si një “palë e interesuar” sikurse përkufizohet në nenin 4 të ligjit sepse nga të dhënat e paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim rezulton se Kërkesa për Rishqyrtim është dorëzuar - paraqitur - nënkuptohet dhe e nënshkruar nga Faton Ibrahim, që për Autoritetin Kontraktues është person jo kompetent për faktin se : të dhënat nga dokumenti - Certifikata e ARBK-së rezulton se pronar i O.E. “ Aritech “sh.p.k. është Fahri Avdiu, po ashtu , sipas dokumentit të ARBK-së , person i autorizuar i O.E. “ Aritech “sh.p.k. rezulton të jetë Fahri Avdiu , në pozitën e punës : Drejtor- Agjent i Regjistruar.

Mbi këtë konstatim, Autoriteti Kontraktues, në procesin e shqyrtimit të dokumentacionit tenderues të dorëzuar nga Ankuesi vlerësoi dhe analizoi përmbajtjen respektivisht të dhënat në dokumentin Formulari i Tenderit dhe, në kuptim të dispozitës të nenit 17 paragrafi 17.7 Rregullores nr. 002/2024 - Plotësim ndryshimi i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik , sipas të cilit Pjesa C - Formulari për dorëzimin e ofertës është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se i ka kontrolluar dhe pranon gjitha kushtet e tenderit, konstatoi se edhe në këtë dokument janë ofruar të dhëna kontradiktore dhe rrjedhimisht jo të rregullta për faktin se Shqipridona Gërguri e paraqitur si person kontaktues nuk ka autorizim të shkruar dhe dorëzuar, nuk është e përfshirë në dokumentin e ARBK-së si përfaqësuese e Ankuesit, “ Aritech “sh.p.k. , andaj edhe në këtë rast, për Autoritetin Kontraktues, personi në fjalë, Shqipridona Gërguri konsiderohet si person jo kompetent për faktin se : të dhënat nga dokumenti - Certifikata e ARBK-së rezulton se pronar i O.E. “ Aritech “sh.p.k. është Fahri Avdiu, po ashtu , sipas dokumentit të ARBK-së , person i autorizuar i O.E. “ Aritech “sh.p.k. rezulton të jetë Fahri Avdiu , në pozitën e punës : Drejtor - Agjent i Regjistruar.

Sipas dispozitave të LPP-së dhe interpretimit nr. 40 të dhënë nga KRPP, citat : “ dokumenti i dorëzuar dhe / ose nënshkruar nga një person në emër të një personi tjetër në Dosjen e Tenderit, përfshirë dhe deklaratën në hetim, pa autorizim nga personi kompetent nuk mund të jetë ipranueshëm për faktin se në Formularët standard të Dosjes së Tenderit, përfshirë dhe > Deklaratën nën betim, dhe dokumentet tjera kërkojnë të dhënat mbi identifikimin e O.E. (sikurse janë : emri dhe mbiemri, pozita , nënshkrimi, data, vula etj) pra kërkojnë të plotësohen dhe nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik, dhe jo nga personi që nuk është kompetent, ose që nuk ka autorizim për ta bërë një gjë të tillë” mbarim i citatit

Këto mangësi të konstatuara, sikurse ka vlerësuar A.K. paraqesin devijime substanciale nga kërkesat e dosjes së tenderit, ato përbëjnë largim dhe kufizim thelbësorë nga Kërkesat e Dosjes së Tenderit për arsye se :

Dallojnë esencialisht nga kushtet dhe dhe specififikimet e dosjes së tenderit;

Afektujnë cilësinë ose ekzekutimin e kontratës;

Kufizojnë të drejtat e A.K. dhe / ose obligimet e tenderuesit sipas kontratës dhe Shtrembëron konkurrencën e tenderuesve, ofertimet e të cilëve janë në pajtueshmëri me rregullat, dhe si të tilla këto mangësi e bëjnë tenderin e Juaj të papërgjegjshëm.

4. Lidhur me pretendimin e juaj se A.K. në procesin e vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, në mënyrë të gabuar ka zbatuar dispozitat e nenit 61 të LPP-së — Tenderi Jo- Normalisht i Ulët , lidhur me nenin 41 të Rregullores nr. 002/2024 - Plotësim ndryshimi i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik , Autoriteti Kontraktues edhe në procesin e rivlerësimit të tenderëve ka vlerësuar dhe konstatuar që tenderi Juaj respektivisht çmimet e furnizimeve dhe / ose shërbimeve të artikullit sipas pozicionit, Artikulli 9, Brand Name Workstation Model V Referuar specifikave ne Aneksin 1 te DT copë 1 5480.568.00 5,919.00 5,480.56 438.44 5,919.00 5,919.00 HP WORKSTATION Z8 G5 - KINE, nga Lista e Përshkrimit të Çmimeve të furnizimeve dhe / ose shërbimeve paraqet çmim jo-normalisht të ulët, në krahasim me objektin e kontratës, gjegjësisht me çmimet e tregut të furnizimeve dhe / ose shërbimeve, bazuar dhe në vlerën e çmimeve të parashikuar nga A.K.

Mbi bazën e të dhënave nga sqarimi juaj lidhur me çmimin e artikujve, konkludohet se shpjegimi Juaj lidhur me sqarimet e ofruara nuk është i mjaftueshëm, nuk është bindës për A.K., rrjedhimisht nuk jep përgjigje të argumentuar ndaj kërkesave të AK sepse në shpjegimet e juaja me shkrim nuk është dhënë ndonjë argument lidhur me ekonominë e procesit të paisjeve të pjesëve - materialeve për të cilat është kërkuar shpjegim, nuk është ofruar ndonjë zgjidhje që do t'ju bënte favore në realizimin e projektit, nuk keni ofruar ndonjë favor tjetër në dispozicionin tuaj për furnizimin e produkteve dhe / ose realizimin e projektit për të cilat keni tenderuar.

Mbi këtë bazë, AK ka bërë edhe një herë vlerësimin e tenderit dhe pretendimeve ankimore të parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim, gjithashtu ka vlerësuar me kujdes çmimet e ofruara nga ju (duke krahasuar edhe me çmimet e tregut dhe, bazuar në të dhënat nga analiza e bërë) bazuar në diskrecionin e tij për të vlerësuar dhe vendosur, ka ardhur në konkludimin se çmimet tuaja në disa pozicione konkrete janë jonormalisht të ulëta në raport me çmimet e artikujve të njëjtë të konfirmuara nga hulumtimi i tregut, prandaj çmimet tuaja të ofertuara për pozicionet konkrete konsiderohen të dëmshme për AK.

Nëse çmimeve të ofertës tuaj i shtohen edhe llogaritja e shpenzimeve tjera vartëse të domosdoshme sikurse janë pagesat e tatimeve dhe kontributeve ndaj ATK-së, si kategori ligjore, shpenzimet vartëse siç janë: pagat për të punësuarit, transporti, garancioni, montimi e të ngjashme, të cilat vërehet se nuk janë marrë në konsideratë prej juve, atëherë padiskutim mund të vijmë në përfundim se çmimet e ofertës suaj për pozicione të furnizimeve të artikujve të identifikuar nga AK dërgojnë në konkludimin nga A.K. se oferta Juaj me çmimet e ofruara, respektivisht ekzekutimi i furnizimeve / ose shërbimeve nuk ka siguri se do të mundë të përmbushet me sukses, ndërsa A.K. do ti shkaktohen dëme financiare dhe vonesa gjatë ekzekutimit të furnizimeve.

Gjithashtu A.K. rithekson edhe njëherë se lidhur me këtë proces të vlerësimit, në pajtim dhe zbatim të dispozitave të nenit 61 paragrafi 4 dhe 5 të LPP-së, me shkrim dhe mbi bazën e informacioneve të nevojshme dhe / ose të arsyeshme, ka njoftuar dhe KRPP-n duke dërguar njoftimin dhe në Platformën elektronike.

Lidhur me pretendimin e Juaj se O.E. i reomanduar për dhënie të kontratës, „ Clastertech „sh.p.k. në dokumentim - Përshkrimi i pozicioneve dhe Çmimeve pjesë e Dosjes së Tenderit, në mënyrë të gabuar ka aplikuar normën e TVSH-së dhe si rrjedhojë do të duhej që tenderi i O.E. në fjalë, për shkak të këtij gabimi dhe korigjimit të çmimit, do të duhej të eliminohej si tenderues i papërgjegjshëm, me arsyetimin se çmimi i korigjuar tejkalon vlerën +- (plus - minus) 2% të vlerës së çmimit të lexuar në procesin e hapjes së tenderëve, A.K. sqaron se në procsin e vlerësimit të tenderëve, në pajtim me interpretimin e

KRPP-së , citat : „ Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-së është e gabuar (më e lartë apo më e ulët se norma e aplikueshme e TVSH-së) Autoriteti Kontraktues do ta korigjoi % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-së pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë „ mbarim i citatit , ka zbatuar dhe vepruar në kuptim të interpretimit në fjalë, dhe në këtë kuptim ka bërë korigjimin e normës së TVSH-së dhe vlerës së përgjithshme të TVSH-së duke mos e ndryshuar çmimin e artikullit të kalkuluar me TVSH-n.

5.A.K. vlerëson se duke marrë këtë vendim ka pasur parasysh dhe mbrojtjen e parimit “ VLERA PËR PARANË “ , duke vlerësuar dhe respektuar fillimisht dispozitat ligjore lidhur me procesin e Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahimit të tenderëve duke marrë për bazë dhe transparencën, Trajtimin e barabartë të O.E. dhe jo-diskriminim në mes të O.E. duke përfunduar me zbatimin e parimit të “ vlera për paranë “ i cili në fakt është parim shumë i rëndësishëm për buxhetin e A.K. dhe të cilin sigurisht se A.K. e ka pasur në konsideratë.

6.Bazuar në të gjitha të cekurat si më lartë në këtë Vendim, A.K. vlerëson se pretendimet e Ankuesit janë të pabazuara, të pasakta dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së.

Përfundimisht, A.K. vlerëson se me rastin e marrjes së vendimit si ai i dt. 22.05.2025 për të përzgjedhur për rekomandim me dhënie të kontratës të O.E.: “ Clastertech “sh.p.k. me seli në Prishtinë nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat e cituara si më lartë në këtë Vendim, me theks të veçantë neni 1 - Qëllimi, neni 7 - Barazia në trajtim/ Jo – diskriminimi sepse është rekomanduar O.E. me tender të përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët ndërsa me asnjë provë nuk është vërtetuar se ndonjë O.E. është trajtuar Jo-barabartë apo diskriminuese, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë në mes O.E., neni 51 - Njoftimi i kritereve të dhënies së kontratës dhe neni 59 parag.4 - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K. përmes këtij Vendimi, janë të pabaza, jo të sakta dhe si të tilla janë hedhur poshtë.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 09.06.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0454/2025, ndërsa me datë 17.06.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0454/2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësas e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertës, parashtrësas dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “ARITECH” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0454 ka vlerësuar si në vijim:

Duke u mbështetur në ekzaminimin e lëndës, konstatojmë si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin nr. 1.

OE ankues "ARITECH SH.P.K." pretendon se Autoriteti Kontraktues – AK KOMUNA E VUSHTRISË nuk e ka respektuar nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti të LPP-së.

Eksperti sqaron se mes tjerash qëllim i këtij neni është ti udhëzoj autoritetet kontraktuese që të sigurojnë mënyrë që të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. AK duhet te kenë kujdesë që Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Sipas pretendimit të OE ankues AK me këtë aktivitet të prokurimit e ka trajtuar OE "ARITECH SH.P.K." si të pa përgjegjshëm, me arsyetimin se oferta e dorëzuar nuk ishte në harmoni me nenin 6 të LPP dhe të gjitha kriteret e parapara, oferta e OE ankues nga AK konsiderohet si tender jo-normalisht të ulët me çmime jo normale dhe të dëmshme për AK dhe që nuk i plotëson kriteret e parapara. Në mënyrë ma të detajuar do ta gjeni përgjigjen më poshtë të pretendimi për shkeljen e nenit 59 të LPP-së dhe nenit 41 të rregullores 002/2024; Tenderët Jo-normalisht të Ulet e që ndërlidhen edhe me këtë dispozitë. Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim qëndron dhe është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2

OE ankues "ARITECH SH.P.K." pretendon se Autoriteti Kontraktues – AK KOMUNA E VUSHTRISË nuk e ka respektuar nenin 7 Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi.

OE ankues pretendon se: Autoriteti Kontraktues me rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së, sepse referuar nenit në fjalë citat: "Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë edhe Neni 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi ku Qëllimi i këtij neni është që Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese.

Eksperti sqaron se ndër të tjera qellim i këtij neni është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet ti trajtojnë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit. Eksperti konstaton se sa i përket këtij pretendimit të OE ankues, i njëjti pretendim është i bazuar, ma gjerësisht do të gjeni përgjigjet veç e veç te secili pretendim përkatës e që ndërlidhen edhe me këtë dispozitë.

Përgjigje në Pretendimin nr. 3

OE ankues "ARITECH SH.P.K." pretendon se Autoriteti Kontraktues – AK KOMUNA E VUSHTRISË nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së.

Eksperti thekson se qellim i nenit 59 të LPP-së, është ti udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet të bëhet Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahاسimi i tenderëve.

OE ankues pretendon: citat: “Autoriteti Kontraktues, lidhur me kërkesën për sqarime shitesë të datës 13.05.2025, ka kërkuar autorizimin e prodhuesit për pozicionin nr. 9 – HP Z8 G5 Workstation. Më datë 14.05.2025, përmes sistemit të e-prokurimit nga ana jone është ngarkuar autorizimi përkatës për produktin HP Z8 G5, si dhe autorizimet e tjera të nevojshme. Edhe pse të njëjtat kanë qene të ngarkuara në AQP!!! Për më tepër, Autoriteti Kontraktues më datë 15.05.2025 ka kërkuar sqarime shitesë lidhur me pozicionin nr. 9 – Brand Name Workstation, modeli HP Z8 G5 Workstation, çuditërisht duke shprehur dyshime për çmim jo normalisht të ulët, si dhe për autorizimin e këtij produkti (edhe pse është ngarkuar një dite përpara, plus asaj që ka qene në AQP).

Insistimi mbi kërkesën për autorizim (MAF) është i habitshëm, duke theksuar se ky artikull nuk ndodhet në listën e autorizimeve të kërkuara. Fakti që “Aritech SHPK” është i kualifikuar në AQP nënkupton që ka autorizim për secilin pozicion, përfshirë edhe Workstation-in! Prandaj, duket qartë që ne fillim, se nuk kemi të bëjmë me një vlerësim profesional, por me një qasje tendencioze! Sidoqoftë, në sistemin e e-prokurimit kemi ngarkuar përsëri Autorizimin nga prodhuesi për këtë produkt, duke e theksuar me ngjyrë tekstin për HP Workstations.”

Eksperti konstaton se ky pretendim i OE Ankues qëndron dhe është i bazuar sepse AK gjatë ekzaminimit të tenderëve ka kërkuar Autorizimin e prodhuesit për pozicionin nr. 9 – HP Z8 G5 Workstation të përshkrimit të çmimeve, Autorizimi i kërkuar nga AK me kërkesën për sqarime të dt. 13.05.2025 konsiderohet si kërkesë jo e drejtë në këtë fazë sepse kjo mundësi për sqarime ka skaduar me rastin e vlerësimit të ofertave për para kualifikim gjatë zhvillimit të procedurës nga AQP. Megjithatë eksperti ka vërtetuar se OE ankues ka dorëzuar në platformën e e-prokurimit autorizimin e kërkuar sipas afateve të përcaktuara në kërkesën për sqarime të AK.

OE ankues pretendon: citat “Në mënyrë të pabesueshme, AK ka kualifikuar “Aritech SHPK”, përkatësisht parashtruesin e ankesës, si person jokompetent për të paraqitur kërkesën për rishqyrtim – pavarësisht se kërkesa është nënshkruar nga pronari i kompanisë, z. Fahri Avdiu, dhe është dorëzuar me vulën zyrtare të kompanisë. Po ashtu, Autoriteti Kontraktues ka kaluar përtej kompetencave të tij, duke ndërmarrë "zbulime" të panevojshme, pa marrë parasysh se “Aritech SHPK” ka realizuar më parë disa kontrata me Komunën e Vushtrisë dhe ka ndjekur të njëjtën praktikë të dorëzimit të ofertave, gjithnjë në përputhje me kërkesat ligjore. Për të gjitha ofertat, përfshirë edhe këtë të fundit, dokumentet janë dorëzuar në emër të pronarit Fahri Avdiu, të nënshkruara prej tij dhe të vulosura nga kompania, në përputhje të plotë me Ligjin për Prokurimin Publik.

Autoriteti Kontraktues ka dëshmuar qartë se nuk ka kryer një vlerësim të drejtë dhe objektiv, pasi vazhdon të insistojë në pretendime të pabazuara dhe nuk merr fare në konsideratë argumentet e paraqitura nga “Aritech SHPK”, përfshirë edhe pretendimin për çmim jonormalisht të ulët. Madje, pa u mjaftuar me këto, AK ka shpikur pretendime të tjera të pabazuara, duke u larguar plotësisht nga parimet themelore të vlerësimit të drejtë dhe të paanshëm. Për më tepër, në lidhje me pretendimin e Autoritetit Kontraktues se kërkesa për rishqyrtim ishte paraqitur nga një person jokompetent, theksojmë se në zyrat e AK-së ekziston dokumenti përkatës – autorizimi për z. Faton Ibrahim. Edhe pse në këtë rast nuk ishte i nevojshëm fare autorizimi, i cili gjendet tek Autoriteti Kontraktues i kerkuar për qasje në dokumente. Sikur mos ta kishim pasur kete dokument, AK kaq i interesuar ta rrezoje oferten tone, nuk do te na kishte dhene qasje fare ne dokumentacion!”

Eksperti konstaton se ky pretendim i OE Ankues qëndron dhe është i bazuar për faktin se ka ofruar prova bindes se Kërkesa për ri shqyrtime e kontestuar nga AK se është paraqiture nga personi jo kompetent me këto prova te dorëzuara nga OE ankues dëshmohet e kundërta se kërkesa për rishqyrtim është paraqiture nga personi kompetent dhe është e rregullte. Megjithatë duhet theksuar se AK ne arsyet e eliminimit nuk e ka cekure ketë si arsye për eliminim ku me këtë kuptohet se AK e ka konsideruar si te rregullte edhe këtë veprim lidhure me kërkesën për rishqyrtim.

OE ankues pretendon, citat: “Megjithatë, është për t’u habitur se sa shumë energji dhe kohë ka humbur Autoriteti Kontraktues duke analizuar vetëm një pozicion të vetëm, ndërsa nuk ka shqyrtuar fare me kujdes të gjithë tabelën e çmimeve të ofruara nga Operatori Ekonomik “Clastertech SHPK”, i cili është propozuar për shpërbllim me kontratë. Më poshtë gjendet tabela e çmimeve të ofruara nga “Clastertech SHPK”: Gabimet në llogaritjen e TVSH-së dhe çmimeve për njësi: Nga shqyrtimi i tabelës së ofertave të dorëzuara nga Operatorët Ekonomikë, rezulton se të gjitha pozicionet e çmimeve janë kalkuluar gabim nga OE që është propozuar për t’u shpërblyer me kontratë. Ky operator nuk ka aplikuar normat ligjore të TVSH-së prej 8% dhe 18%, sipas natyrës së produkteve, dhe si rrjedhojë kemi të bëjmë me gabime aritmetike që tejkalojnë 2%, çka sipas legjislacionit për prokurimin publik e klasifikon ofertën si të papërgjegjshme. Shembull konkret: • Pozicioni nr. 1 o Çmimi njësi pa TVSH: 111.84 euro o Çmimi njësi me TVSH të deklaruar: 112.04 euro o Gabimi i dukshëm: TVSH prej vetëm 0.18 euro është në kundërshtim me normën ligjore. o Llogaritja korrekte, nëse çmimi bazë real do të ishte 111.84 euro dhe aplikohet 18% TVSH, do të rezultonte: $111.84 (111.84 \times 0.18) = 131.97$ euro Ky është vetëm një nga pozicionet ku llogaritjet janë bërë gabim. Gabime të ngjashme shfaqen në të gjitha pozicionet e tjera në tabelën e ofertës, për shkak të moszbatimit të normës së duhur të TVSH-së dhe gabimeve në shumzimet aritmetike. Shih printscreen ne Ankesën në PDF: Me ngjyrë të kuqe janë shënuar çmimet e korrigjuara. Sipas përlllogaritjes së re, pas përmirësimit të çmimeve, totali i ofertës rezulton të jetë 122,945.96 EUR. Gabimi aritmetik në total është 8%, çka e klasifikon ofertën si të papërgjegjshme, sipas kritereve të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe LPP, dhe njëkohësisht e rendit këtë ofertë si më të shtrenjtën ndër operatorët konkurrues”.

Eksperti konstaton se pretendim i OE ankues lidhure me atë se OE Clastertech SHPK nuk ka aplikuar normat ligjore të TVSH-së prej 8% dhe 18%, sipas natyrës së produkteve, dhe si rrjedhojë kemi të bëjmë me gabime aritmetike që tejkalojnë 2%, çka sipas legjislacionit për prokurimin publik e klasifikon ofertën si të papërgjegjshme. Eksperti ka shqyrtuar me kujdes këtë pretendim, gjate shqyrtimit te këtij pretendimi kam marre për baze edhe interpretimin e KRPP për një aktivitet te prokurimit te mëhershëm te ngjashëm me këtë pretendim, interpretimi i KRPP është si vijon; “Paragrafi 3 i nenit 59 te LPP-se flet për gabimet tërësish t aritmetikore dhe sipas këtij neni nëse gjate vlerësimit te tenderëve AK zbulon mospërputhje ne

mes te çmimit për njësi dhe totalit, çmimi për njësi do te mbizotëroje dhe një përmirësim i tille lejohet vetëm deri ne 2% te vlerës totale te ofertës.

Si rrjedhoje, nëse ne ofertën e OE-se nuk ka mospërputhje në mes çmimit njësi dhe totalit, por ka gabime vetëm ne përcaktimin e normës se TVSH-se nga ajo qe e përcakton ligji mbi TVSH-ne, opinioni i KRPP-se është se AK nuk mund te klasifikojë këtë si gabim ne llogaritje +/- 2% duke u bazuar ne paragrafin 3 te nenit 59 te LPP-se sepse kjo është një situatë tjetër nga ajo qe rregullon paragrafi ne fjale , prandaj KRPP iu këshillon te veproni ne përputhje me interpretimin e publikuar ne ueb-faqen e KRPP tek "Pyetjet e shpeshta" Pyetja me Nr. 46 dhe te merrni një vendim ne përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit dytësor te nxjerre nga KRPP ne baze te autorizimeve qe i janë dhënë me këtë ligj”.

Eksperti Konstaton se pretendimi i OE ankues nuk qëndron për faktin se te gjitha dipozitat ligjore, dhe interpretimet e prezantuara si me sipër e detyrojnë autoritetin përkatës kontraktues qe ne rastet e aplikimit jo te duhur apo mos aplikimit te vlerës dhe përqindjes reale te TVSH-se, përgjatë procesit te vlerësimit te ofertave ti ndërmarrin veprimet korrigjuese konform normave ligjore për llogaritje te TVSH dhe ta njoftojnë OE përkatës me ndryshimet e mundshme rrjedhimisht te procedohet tutje por jo te eliminohet oferta si e pa përgjegjshme.

Me këtë rast unë si ekspert shqyrtues përgjatë analizës qe i kam bere këtij vlerësimi nuk kam gjetur se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për llogaritjen gjegjësisht analizën për gabimet eventuale te vlera e TVSH, këshillohet AK qe te ndërmarrë veprimet e nevojshme konform rekomandimeve te mësipërme.

Përgjigje në Pretendimin nr. 4.

OE ankues "ARITECH SH.P.K." pretendon se Autoriteti Kontraktues – AK KOMUNA E VUSHTRISË nuk e ka respektuar nenin 41 i Rregullores 002/2024: Tenderët Jo-normalisht të Ulët.

OE ankues pretendon, “Për me tepër, Autoriteti Kontraktues më datë 15.05.2025 ka kërkuar sqarime shtesë lidhur me pozicionin nr. 9 – Brand Name Workstation, modeli HP Z8 G5 Workstation, çuditërisht duke shprehur dyshime për çmim jo normalisht të ulët, lidhur me pretendimin e çuditshëm për çmimin jo normalisht të ulët për HP Workstations, theksojmë si më poshtë: E para nuk janë plotësuar kushtet për tu trajtuar si çmim jo normalisht i ulët, megjithatë “Aritech SHPK”, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, ka siguruar dëshmi të mjaftueshme që çmimi i ofruar për produktin Workstation është çmim tregu dhe nuk përbën çmim jonormalisht të ulët. Dëshmia konsiston në: • Çmimi i ofruar nga Operatori Ekonomik në tender në vlerë 5,919.00 EUR është 9.56% më i lartë se kostoja totale e blerjes, transportit, shpenzimeve të doganimit dhe taksave. Kjo është dëshmuar me faturën blerëse për një projekt të vitit aktual të kompanisë “Aritech SHPK” në administratën e shtetit, si dhe me OPG-në nga prodhuesi (OPG është çmimi zyrtar i aprovuar nga prodhuesi HP). • Marzhi prej 9.56% në projektin në vlerë mbi 100,000 EUR mbulon afërsisht gjysmën e shpenzimeve operative mujore të gjithë kompanisë, që dëshmon se ky produkt, si dhe i gjithë tenderi, është me fitim për kompaninë! • “Aritech SHPK” është i vetmi partner direkt i HP-së për Kosovën. Duke qenë partner direkt, “Aritech” ka çmime më të favorshme blerëse sesa operatorët e tjerë në treg.

Për më tepër, për te treguar seriozitetin e kompanisë “Aritech SHPK” ne raport me komunën e Vushtrisë, AK është ne dijeni se OE Aritech ka realizuar me sukses projekte të ngjashme gjatë tri viteve të fundit pranë të njëjtit Autoritet Kontraktues, në vlerë totale 419,298 EUR- ne vijim referencat e këtyre projekteve: • Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative – Ri-tenderim / VU644-22-8499-5-5 8 • Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative / VU644-23-4202-5-5-8 • Furnizim me pajisje të

Teknologjisë Informativë / VU644-24-7363-5-5-8). Për këto projekte kemi marrë referenca pozitive nga Autoriteti Kontraktues hiq me larg se këtë muaj!!!!,

Dëmtimi i buxhetit të komunës prej 8,697.78 EUR për shkak të një hamendësimi të pabazuar nga Autoriteti Kontraktues është i dëmshëm për komunën, ndërkohë që ne si operator jemi të detyruar të kërkojmë të drejtën tek Ju, gjë që për AK mund të ketë vonesa shtese te panevojshme dhe harxhim te resurseve te OSHP. Për të vërtetuar më tej këtë dhe si dëshmi shtesë, kemi siguruar Dokumentin Unik Doganor (DUD) që lëshohet nga Drejtoria e Doganave të Kosovës, me të cilin është bërë zhdoganimi për sasinë prej 4 copësh Workstation IDENTIK. Ky dokument është bashkëngjitur së bashku me faturën blerëse dhe faturën shitëse për Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë. Dokumenti Unik Doganor – Nr. R2211 Artikulli 4: HP Workstation Tower Z8 G5 • 2x CPU Xenon 5418Y • 32GB RAM • 1 TB SSD • 2 TB HDD • 8GB Kartelë Grafike Çmimi njësi (pa taksa): 4,858.10 EUR Totali për 4 cope: 19,432.40 EUR

Vlerësim për çmimin e ofruar nga “Aritech SHPK”: Vlerësojmë se kemi ofruar dëshmi mëse të mjaftueshme për të lehtësuar vendimmarrjen e Autoritetit Kontraktues. Për më tepër, çmimi i ofruar nga “Aritech SHPK” nuk përmbush kriteret për të kërkuar sqarime shtesë në lidhje me çmimin jonormalisht të ulët. Sipas Rregullores përkatëse me Nr. 002/2024, për të klasifikuar një ofertë si “jo normalisht të ulët” apo për të kërkuar sqarime mbi çmimin e ofruar, duhet të plotësohen kriteret e përcaktuara në këtë rregullore. Citojmë nga Neni 41 – Tenderët Jo-normalisht të Ulët: Përfundim – Citati: Megjithatë, është për t’u habitur se sa shumë energji dhe kohë ka humbur Autoriteti Kontraktues duke analizuar vetëm një pozicion të vetëm, ndërsa nuk ka shqyrtuar fare me kujdes të gjithë tabelën e çmimeve të ofruara nga Operatori Ekonomik “ClasterTech SHPK”, i cili është propozuar për shpërblim me kontratë.

Eksperti konstaton, lidhure me pretendimin e mësipërm të OE ankues për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, në nenin 61 të LPP citohet se “Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që është ose duket të jetë jo normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragraf 2. të këtij neni.”

AK edhe pse nuk janë plotësuar dy kushtet e para pika i. dhe ii. që i parasheh neni 41.3 i rregullores së prokurimit publik për t’u trajtuar si tender jo normalisht i ulët oferta e OE gjegjësisht pozicioni nr. 9 nuk e ka marrë për baze fare përgjigjen e kërkuar nga OE përkundër fakteve dhe provës kryesore siç ka bashkëngjiturë DUD-in nga Dogana e RKS ku vërehet çartë se çmimi i ofruar për këtë pozicion është çmim i përafërt me çmimet e tjera të ofruara nga OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në shikimin e ofertës së OE ankues, sqarimeve të ofruara dhe krahasimit të çmimit për të cilin pozicion dyshon AK, konstatoj se pretendimi i OE ankues qëndron dhe është plotësisht i bazuar (prove; Dokumenti Unik Doganor-DUDI i i lëshuar nga Dogana e Kosovës i dorëzuar nga OE ankues në platformën e e-prokurimit).

Eksperti konstaton se ky pretendim qëndron dhe është i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë

panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues të cilave ju a fal besimin, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim për AK i cili obligohet të veproj në harmoni me rekomandimet e ekspertëve shqyrtues/teknik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe duke u mbështetur në konstatimet e ekspertit shqyrtues është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim, dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin “Furnizim me pajisje të teknologjisë informative” me nr. të prokurimit: VU644-25-1910-5-5-8. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ARITECH” dhe se argumentimi në raportin e ekspertës është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertës mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ARITECH” janë të bazuara.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit e shih si të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me “Furnizim me pajisje të teknologjisë informative” me nr. të prokurimit: VU644-25-1910-5-5-8, të anulohet njoftimi për dhënie dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRISË**
- **OE - ARITECH**
- Arkivës së OSHP-së: